



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Nr. prot. DA342/2025/14

Nr. prot. 2318/1

Tiranë, më 11.08.2025

Tiranë, më 11.08.2025

KONTRATË DHURIMI

Kjo Kontratë Dhurimi nënshkruhet sot, 11 / 08 /2025 ndërmjet palëve të mëposhtme:

DHURUESI: Helvetas Swiss Intercooperation e regjistrua, me NIPT K 67303002 B, në adresën: Rruga : Ismail Qemali”, P.18, H.3, Ap, 15, Tiranë, kompania zbatuese e Projektit RisiAlbania, Shqipëri, përfaqësuar nga **Z. Stephan Joss si Drejtor Projekti dhe Znj. Edlira Muedini si Menaxhere e Projektit RisiAlbania**, (Dhuruesi)

dhe

PËRFITUESI: “Universiteti Bujqësor i Tiranës” me seli në Rr. Paisi Vodica Nr. 1025, Kodër Kamëz, Tirane, regjistruar me Numrin Unik të Identifikimit të Subjektit (NUIS) **J61915028N** përfaqësuar nga Administratori Z. Edmond Tërthorja, Në Mungesë dhe me Vendim, Znj. Valbona Shehu;

(Përfituesi)

Palët bien dakord për lidhjen e kësaj kontrate si më poshtë vijon:

Neni 1

Baza ligjore

1.1 Kjo Kontratë u përpilua në bazë të dispozitave në fuqi të Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994, Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar), neni 761 e vijues;

Neni 2

Objekti

2.1 Objekti i kësaj kontrate është dhurimi nga ana e Dhuruesi në favor të Përfituesit i 86 kopjeve të Kompendiumit të Bimëve Mjekësore dhe Aromatike, të cilat do të përdoren për të rritur rolin e Universitetit si transferues i njohurive në sektor dhe forcuar bashkëpunimin midis Universitetit dhe sektorit privat.

Nr	Objekti	Njësia	Sasia
1.	Kompendium BAM	kopje	86

Neni 3

Detyrimet e palëve kontraktuese

3.1. Dhuruesi merr përsipër:

- a. Të realizojë dhurimin e materialeve , në kuadër të sponsorizimit sipas kësaj Kontrate Dhurimi të lidhur midis palëve.
- b. Të dorëzojë dhurimin e realizuar nëpërmjet procesverbaleve të nënshkruar nga të dyja palët.

3.2. Përfituesi merr përsipër:

- a. Të menaxhojë marrëdhëniet me dhuruesin, të finalizojë kontratën dhe të monitorojë praktikën e dhurimit sipas nevojave dhe standardeve të përcaktuara.
- b. Të deklarojë se dhurimi i realizuar është në përputhje të plotë me nevojat dhe kërkesat e rena dakort mes palëve dhe i përshtatet qëllimit të dhurimit përcaktuar në këtë kontratë.

Neni 4

Kohëzgjatja

- 4.1 Kohëzgjatja e kësaj kontrate përcaktohet nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate, deri në datën e dorëzimit tek Përfituesit të dhurimit, realizuar nga “**Helvetas Swiss Intercooperation**” për Universiteti Bujqësor të Tiranës”.

Neni 5

Marrja në dorëzim

- 5.1 Dhuruesi do t'i dorëzojë sendet objekt dhurimi pranë Selisë së Përfituesit menjëherë pas nënshkrimit të kësaj Kontrate. Dhuruesi me anë të një procesverbali i cili përshkruan objektin e dhurimit dhe gjëndjen e tyre paraqitet pranë Përfituesit, dhe të dy palët nënshkruajnë procesverbalin e dorëzimit.
- 5.2 **Universiteti Bujqësor i Tiranës** ngarkohet të marrë në dorëzim objektin e dhurimit me procesverbal të nënshkruar nga të dy palët.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 6.1 Secila nga palët rezervon të drejtën për tu tërhequr nga kjo Kontratë, por duhet të njoftojë palën tjetër me shkrim të paktën 5 ditë kalendrike përpara prishjes së saj.
- 6.2 Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet dhuruesit dhe përfituesit zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt palët drejtohen për zgjidhjen e tyre në Gjykatën kompetente të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Neni 7

Njoftimet

- 7.1 Të gjitha njoftimet dhe komunikimet midis palëve në këtë marrëveshje bëhen me shkrim duke iu dorëzuar personalisht personave të kontaktit, si më poshtë vijon:



A) Për Përfituesin: Universiteti Bujqësor i Tiranës

Administratori Z. Edmond Tërthorja, Në Mungesë dhe me Vendim, Administratori i Njësisë Kryesore të UBT, Znj. Valbona Shehu;
e-mail: vskenderi@edu.al;

B) Për Dhuruesin: Helvetas Swiss Intercooperation

Z. Ergent Pire
Menaxher i Ndërhyrjeve Agrobiznes, Projekti RisiAlbania
e-mail: ergent.pire@helvetas.org;

Neni 8

Hyrja në fuqi

8.1 Kjo Kontratë Dhurimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët.

Neni 9

Dispozita të fundit

9.1 Palët përgjigjen reciprokisht për respektimin e kësaj kontrate.

9.2 Janë pjesë përbërëse dhe e pandarë e kësaj kontrate i gjithë dokumentacioni:

- *procesverbali i marrjes në dorëzim i firmosur nga palët.*

9.3 Kjo kontratë përbën marrëveshjen e plotë mes palëve. Çdo shtesë apo ndryshim i kësaj kontrate bëhet vetëm me miratimin në formë të shkruar të të dyja palëve në kontratë.

9.4 Kjo kontratë hartohet në 2 (dy) kopje, nga 1 (nje) kopje origjinale për secilën palë,

DHURUESI

PËRFITUESI

Për Helvetas Swiss Intercooperation

**Për Universitetin Bujqësor të Tiranës
Edmond Tërthorja**

**Drejtor i Projektit Risi Albania
Stephan Joss**

Në Mungesë dhe me Vendim

**Administratori i Njësisë Kryesore të UBT
Valbona Shehu**

**Menaxheri e Projektit Risi Albania
Edlira Muedini**

